



## **GARË STUDENTORE NË ORATORI ME RASTIN E DITËS SË EVROPËS - 9 MAJ**

**Qendra për Shërbime Studentore dhe Karrierë - QESHK**, në bashkëpunim me **Lëvizjen Evropiane në Maqedoni**, këtë vit me rastin e shënimit të 9 Majit, ditës së Evropës, organizojnë **“Garë Studentore në Oratori”**. Në këtë garë oratorie të organizuar nga Lëvizja Evropiane në Maqedoni, me nga 3 përfaqësues të tyre, do të marrin pjesë të gjithë universitetet e akredituara të Maqedonisë. Gara finale e oratorisë do të zhvillohet në Universitetin Shtetëror të Shtipit.

Universiteti Shtetëror i Tetovës në këtë garë studentore oratorie do të prezantohet me 3 oratorët më të mirë, të cilët do të përzgjidhen pas një procesi seleksionimi nga ana e një **Komisioni Vlerësues** të përbërë nga profesorë, të krijuar enkas për këtë garë studentore të oratorisë në USHT.

Të gjithë studentët e USHT-së të cilët zotërojnë aftësi oratorie, si dhe njohuri rreth proceseve euro-integruese të vendit, ftohen të marrin pjesë në këtë garë.

### **Kriteret e pjesëmarrjes/aplikimit:**

- të jenë studentë të Universitetit Shtetëror të Tetovës
- të mos kenë qenë fitues të ndonjë çmimi në manifestimet e mëparshme të organizuar nga Lëvizja Evropiane në Maqedoni

### **Rregullat e garës së oratorisë:**

- paraqitja e çdo oratori në foltore është në kohëzgjatje prej 5 minutash
- paraqitja e oratorëve do të jetë në gjuhën shqipe
- tema e shtjelluar nga oratorët duhet të jetë e ndërlidhur me proceset euro-integruese
- oratorët mund të paraqiten në foltore edhe me letër (*kjo nuk preferohet, por është e lejuar*)
- komisioni vlerësues përzgjedh 3 oratorët më të mirë menjëherë pas përfundimit të garës

### **VËREJTJE:**

**3 oratorët më të mirë të zgjedhur nga Komisioni Vlerësues, do të jenë ata që do të përfaqësojnë Universitetin Shtetëror të Tetovës në “GARËN FINALE TË ORATORISË” që do të mbahet në Universitetin Shtetëror të Shtipit, më datë: 05 Maj 2010 (e mërkurë).**

Të gjithë studentët e interesuar që duan të jenë pjesë e kësaj gare të oratorisë, duhet të vizitojnë zyrat e Qendrës për Shërbime Studentore dhe Karrierë - QESHK, për të plotësuar formularin e aplikimit, më së voni deri më datë **28 PRILL 2010**.

**Përzgjedhja e 3 oratorëve më të mirë do të bëhet më datë: 30 PRILL 2010 - në ambientet e Rektoratit të USHT-së.**